



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 01/144  
Datë: 04.05.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet ekstrakti i procesverbalit dhe transkripti nga mbledhja e 140 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/144  
Datë: 04.05.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2017**

1. Në Programin Legjislativ të përfshihen Projektligjet si në vijim:
  - 1.1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës 31.08.2017 (ZKM);
  - 1.2. Projektligji për Agjencinë e Tatimeve dhe Doganës së Kosovës (MF);
  - 1.3. Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA2016 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian (MF);
  - 1.4. Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës ("MASHT") dhe Stitching Spark-ut të Holandës ("SPARK") mbi mbështetjen e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë (MASHT);
  - 1.5. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-159 për Zonat Ekonomike 30.11.2017 (MTI).
2. Ngarkohet Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 03/144  
Datë: 04.05.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 094 për Presidentin e Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


**Nr. 04/144**  
**Datë: 04.05.2017**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet me vërejtje Projektligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.
2. Ngarkohet Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit në koordinim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për përfshirjen e vërejtjeve në tekstin e Projektligjit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/144  
Datë: 04.05.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Masat e përcaktuara në Rregulloren (QRK) – Nr. 21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike, vlejné brenda dy vitesh nga fillimi dhe zyrtarizmi i punës së Komisionit.
2. Obligohet Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut të vazhdojë punën edhe për 1 (një) vit, sipas ndryshimeve të përcaktuara në këtë rregull.
3. Ndryshimet e përcaktuara sipas këtij vendimi obligohet Zyra Ligjore e Zyrës së Kryeministrit që t'i përfshijë në Rregulloren (QRK) – Nr. 21/2015.
4. Obligohen të gjitha institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores (QRK) – Nr. 21/2015 me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me këtë vendim.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 06/144  
Datë: 04.05.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 paragrafi 8. të Ligjit nr. 05/L-125 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2017, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. protokollit 944/2 të datës 25.04.2017, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet rialokimi i mjeteve në shumë prej 569,639.00 euro në buxhetin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, nga nën programi Administrata Qendrore (11312) nga projekti "Bashkëfinancim me IPA për zhvillim regjional" me kod 13134, në përputhje me 14 (katërmëdhjetë) marrëveshjet e mirëkuptimit, të nënshkruara nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe kryetarët e komunave, për projekte kapitale.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/144  
Datë: 04.05.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Zhvillim Ekonomik Lokal.
2. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/144  
Datë: 04.05.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. protokolli 144/3 dhe 2688/3, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2017, nxjerr këtë:


**V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R**

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat preken nga ndërtimi i Autostradës R6 Prishtinë-Hani i Elezit, Sektorët C1, C2, C2a dhe C2b Zonat Kadastrale: Preoc, Suhudoll, Dobratin, Komuna Graçanicë, Lipjan, Babush i Muhaxherëve, Konjuh, Smallushë, Marec, Gadime e Ulët, Banullë, Komuna Lipjan, Papaz, Sazli, Babush i Sërbve, Mirash, Cërnillë, Rahovicë, Softaj, Bibaj, Fshati i Vjetër, Pojatë, Sojevë, Komogllavë, Talinoc i Muhaxherëve, Gërlicë, Rakaj, Komuna Ferizaj dhe Zonat Kadastrale Koxhaj dhe Kaçanik i Vjetër, Komuna Kaçanik, sipas tabelave pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokolli 4165/16 datë 21.09.2016.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara sipas pikës 1. të këtij vendimi.
4. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.



6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe 1 (një) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar me këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastralë në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryejë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/144  
Datë: 04.05.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. protokolli 222/2, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R**

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga Rikonstruktimi i Rrugës Nacionale N2, Udhëkryqi Gjilan-QMI, Zona Kadastrale Llapna Sellë, Komuna e Graçanicës, sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokolli 1102/17 datë 01.03.2017.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara sipas pikës 1. të këtij vendimi.
4. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.



6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe 1 (një) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar me këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastralë në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryejë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 10/144**  
**Datë: 04.05.2017**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. protokolli 1024, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R**

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme private, komunale dhe shoqërore të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i "Zonës Ekonomike-Industriale" përballë "Parkut të Biznesit në Drenas", përkatësisht Zona Kadastrale Sankoc, Komuna Drenas, sipas tabelës pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokolli 293/17 datë 18.01.2017.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara sipas pikës 1. të këtij vendimi.
4. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse të këtij vendimi, brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.



6. Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që 5 (pesë) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe 1 (një) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.
7. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastralë në emër të titullarëve të rinj, si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryejë veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Isa MUSTAFI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 11/144  
Datë: 04.05.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën me nr. protokolli 959, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim për interes publik i pronave shoqërore të KBI "Kosova Export" dhe NSH "Bujqësia" Obiliq, parcelat P-72614055-01459-1 me sipërfaqe prej 14519m<sup>2</sup> dhe P-72614055-01459-13 me sipërfaqe prej 88299m<sup>2</sup>, të cilat preken nga realizimi i Projektit për renovimin e Stadiumit të Futbollit "Agron Rama" Zona Kadastrale, Obiliq, Komuna Obiliq, sipas tabelës të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, e cila tabelë është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 02/2015 për miratimin e metodave dhe kritereve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Komuna e Obiliqit.
4. Mjetet financiare për kompensimin e shpronësimit të pronave, shpenzimet e procedurës së shpronësimit dhe vlerësimit do të sigurohen nga Komuna e Obiliqit.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


**Nr. 12/144**  
**Datë: 04.05.2017**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Autorizohet Ministri i Financave të aprovojë ndarjen e mjeteve nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100 në vlerë prej 80,000 (tetëdhjetë mijë euro) për vitin 2017.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, kategoria ekonomike shpenzime kapitale në nën-programin Investimet kapitale në Arsimin para universitar me kod 98100 për projektin "Sanimi i kulmit të shkollës fillore Ramë Bllaca" në Bllacë-Suharekë.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për zbatimin e këtij vendimi
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 13/144  
Datë: 04.05.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete në vlerë 9.600,00 (nëntëmijegjashtëqind) euro, sipas kërkesës së Këshillit Koordinues të Asociacioneve Familjare të të Zhdukurve të Kosovës, për mbulimin e shpenzimeve të aktiviteteve të rregullta vjetore me rastin e shënimeve të ditëve të veçanta për persona të zhdukur.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga buxheti për shpenzimet e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere dhe barten në llogarinë bankare me nr. 1503001002032142-Raiffeisen Bank, të Këshillit Koordinues të Asociacioneve Familjare të të Zhdukurve të Kosovës (KKAfZHK).
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


**Nr. 14/144**  
**Datë: 04.05.2017**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2010 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Z. Bekim Hoxha, emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Regjistrimit Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë 3 (tre) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

**Nr. 15/144**  
**Datë: 04.05.2017**

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2017, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Regullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë